

INTERVISTË ME AKADEMIKUN PROF. Dr. KOPI KYÇYKU

Gabimet në politikë janë krime

Nëqoftëse nuk je i zoti për një punë, le të vuajë familja jote. Gjynah për të, por kështu i "qenka shkruar". Por jo të vuajë një popull i tërë. I madhi Faik Konica ka plotësisht të drejtë se, gabimet e politikanëve të paaftë, të pandershëm, apo të dyja bashkë, të paktën frenojnë zhvillimin e një vendi dhe e errësojnë perspektivën e tij për dekada, në mos po edhe për periudha më të gjata.



NE BRENDESI

MOKRA E FISNIKËRISË

Nga MEVLUD BUCI

Ka shume vite që pata dëgjuar dhe lexuar për Mokrën dhe mokrarët, ka shumë vite që njoh bijë të kësaj treve. Tek ata më ka lënë mbresa shpirtbardhësia, zelli i punës dhe bujaria. Që të tria vetëm e vetëm të çojnë tek fisnikëria njerëzore.

SHËNIME PËR LIBRIN "HISTORIA E LUFTËS-KOSOVË-NATO-SHQIPËRI" TË N/KOLONEL ZENUN FEROS

Epopeja e lavdishme e Luftës së Kosovës



Nga Haki BALLIU

Publicisti tanimë i mirënjohur, Zenun Fero, na befason me librin e tij të tretë "Historia e Luftës Kosovë-Nato-Shqipëri". Më së pari autorin e admiroi për vullnetin dhe kontributin e tij në fushën e historisë së artit ushtarak shqiptar. Më parë botimi i librit "Artileria Shqiptare" e tani vështrimi mbi Luftën e Kosovës, janë pasuri që rrallë kush na i sjell. Madje dhe libri "Slabinja e Jonë", ashtu si dhjetëra artikuj në organet e shtypit ushtarak, janë plot ngjarje nga luftërat e së shkuarës.

Mesazhe tolerance dhe bashkëpunimi, nga kreu i shtetit

Vizita e Presidentit të Republikës, z. Bamir Topit në Bashkinë e Qytetit Pogradec duhet parë e lexuar si një eveniment shumë i rëndësishëm për gjithë shoqërinë shqiptare e veçanërisht politikanëve të këtij vendi kaq të pakuptimtë, mjerane, për gjithë këto vite e vite të shkuara dem për mentë e kokës.

Nga Koço PIHONI



Aranitët dhe Mokra

Nga Zenun FEROS



Djali Davidit, Konstandini ishte gjeneral në ushtrinë bizantine në Ballkan, dhe u vra në luftë në vitin 1050, për t'u mbrojtur nga sllavët e uraleve. Në vitin 1274 Sevast Araniti ishte,

Ah, moj Mokër!

Nga Agron MEÇAJ

Kam lindur në Tepe lenë në vitin 1953. në vitin 1972 kam përfunduar shkollën ushtarake Skënderbej me rezultate te shkëlqyera. Dhe për këto rezultate mu dha e drejta që të vazhdoja universitetin e Tiranës në degën Gjeologji Miniera.

Si gjeolog kam punuar 33 vjet në Pukë, Kukës, Has, Peshkopi, Bulqizë, Valias, Mushqeta dhe Dajt. Kam punuar në ndërtimin e hidrocentraleve të Holtës, Gramsh dhe Bishnicë Mokër.

Por për këto që kam lëvizur dhe kam kaluar mbresa më ka lënë Mokra për të

Murat Kajaçka
Istref HAXHILLARI

SHOQATA "PELIONI" DHE STAFI GAZETËS "MOKRA" FESTON VITIN E RI -2011

Viti i ri festohet nga të gjithë popujt e botës. Ai sjell gëzime, takime dhe urime të përzemërta dhe ndryshime nga një vit në tjetrin.

Disa rriten, disa plaken, disa gëzohen dhe disa hidhërohen!. Por viti i ri festohet nga të gjitha nivelet nga çdo shtresë e popullsisë, shoqatate, stafe, dhe institucionet përkatëse.

Ishte 26 dhjetori 2010, Shoqata "Pelioni" dhe stafi gazetës "Mokra" u mbold

Falënderojmë gjeneralin Dhori Spirollari për sponsorizimin e këtij numri



PRESIDENTI BAMIR TOPI VIZITON POGRADECIN!

Mesazhe tolerance dhe bashkëpunimi, nga kreu i shtetit Topi

Vizita e Presidentit të Republikës, z. Bamir Topit në Bashkinë e Qytetit Pogradec duhet parë e lexuar si një eveniment shumë i rëndësishëm për gjithë shoqërinë shqiptare e veçanërisht politikanëve të këtij vendi kaq të pakuptimtë, mjerane, për gjithë këto vite e vite të shkuara dëm për mentë e kokës.

Vizita e zotit President është “dhurata” e shërbimi më i mirë që Kryetari i Shtetit i bën gjithë politikës në këtë vend, asaj të majtë e të djathtë. Mesazhin që ai përcjell nga kjo vizitë, duhet të jetë një moment reflektimi për gjithë klasën politike në këtë vend, për të gjithë ata që kanë sy e duhet të shkojnë, për të gjithë ata që kanë veshë e duhet të dëgjojnë, për të gjithë ata që kanë mend e duhet të mësojnë, për t’i shërbyer këtij vendi e këtij populli që pret nga këta politikanë mjeranë të reflektojnë e me ndërjegjeje të pranojnë se janë treguar shpesh meskinë, cinikë, të veckël, të pavlerë e të pa dobishëm ndaj Shqipërisë e shqiptarëve. Sot po kërkohet që të shikohet se si mundet të ecet përpara, duke parë e mbrapa, cili është ky “çelës” magjik? Mjafton të lexojë “mesazhin” historik, të cilin e “mësoj” zoti President nga vizita shumë domethënëse në Bashkinë e Qytetit të Pogradecit e këshillin e saj Bashkiak.

Në datën 13. 01. 2011 në orët e paradites të kësaj dite mbërrin për një vizitë pune në Pogradec, Kryetari i Shtetit Shqiptar zoti Bamir Topi, të cilit ju urua mirëseardhja nga qindra qytetarë e qytetare pogradecarë në shesh e bulevardin para bashkisë të qytetit. Më duhet të them se kjo vizitë nga qytetarët e vjetër të qytetit konsiderohet si ogur bardhë për qytetin mbasi është dhe dita e parë e vitit sipas kalendarit Gregorjan. ku populli i kësaj ane e vlerëson së tepërmi “këmbën e parë” nëpër familje dhe aq më shumë për gjithë qytetin duke besuar se ky person sjellë mbarësi!

Dhe besojmë e shpresojmë se kështu duhet të jetë ky vit për qytetin e qytetarët e Pogradecit e gjithë Shqipërisë. Ardhja e zoti Bamir u prit me duartkrokime e më pas me shtrëngime duarsh të Presidentit me dhjetëra e dhjetëra qytetarë me shumë ngrohtësi, për të vazhduar më tej me pritjen zyrtare të përgatitur nga ana e Kryetarit të Bashkisë të Qytetit, njëheras dhe Kryetari i Shoqatës së Kryebashkiakëve të gjithë Shqipërisë zoti Artan Shkëmbi duke vazhduar më pas në një takim me të gjithë antarët e këtij Këshilli Bashkiak e Kryetarin e saj zoti Gjergji Ilo. Në këtë takim që ai zhvilloj në një nga “Parlamentet e pushtetit vendor të vendit” besoj se ishte e programuar nga Presidenti i cili kishte zgjedhur këtë Bashki të vendit, jo rastësisht. Z. Topi në atë takim ju raportua për punët e realizuara gjatë vitit 2010, problemet e shqetësimet që këshilltarët kish-

in e diskutuan me preokupim, transparencë e shumë respekt për fjalën e njëritjetrit, pa dallim besimi fetar, bindje politike e pozicioni shoqëror. Ajo që i dallon e i bashkonte këta këshilltarë ishte Qytetaria, edukata, fryma kolegjiale, gjuha e mirëkuptimit në dhënien e drejtë të vendimeve si përfaqësues të vërtetë të zgjedhëseve të tyre. Ky ishte “çelësi” i suksesit, këtu nuk kish çështje të ngelura pezull, për shkak të gjuhës e frymës konfliktuale. Të këtë “Parlament vendor” zoti President pa e mësoj se këtu janë të huaja arroganca, egërsia, urrejti, banaliteti, mëria e ligësia. Është ky tabani, kjo fryma e përgjithësime që bën dhe ndonjë mendësi e gabuar të reflektojë. Është kjo frymë e shëndoshë në këto mendje të kthjelltë, nuk gjen vend as destruktiviteti i politikës së “madhe” të kokave të nxehta, që fatkeqësisht na bëjnë të ndjehemi e ne të turpëruar nga ky Parlament i gjithë Shqipërisë, apo në qytete të vendit. Ku shqiptarët shohim se atje kanë për moral fyerjet, sharjet, egërsinë, mërinë, hakmarrjen dhunën, mungesën e edukatës e të mirëkuptimit, gjetjen e gjuhës së zgjidhjes të problemeve për të cilat janë votuesuar, ku toleranca dhe qytetaria janë të munguara dhe të zëvendësuar me “Gërr mërre” produkt i edukatës të lidhshmeve, shpesh reminishenca të vend origjinës së tyre e të përfaqësuesave politikë që shpesh nuk kanë asgjë të përbashkët me elektoratit që ata përfaqësojnë, por janë të rreshtuar verbërisht, duke deformuar vullnetin e elektoratit që i ka votuar. duke u bërë imazhi më i keq i përfaqësimit të vlerave të popullit tonë dinjitoz në sy të gjithë shqiptarëve e ndërkombëtarëve të cilët vlerësojnë virtytin e popullit shqiptar Tolerancën si vlerë universale. Besoj se ky ishte leksioni që mori e vlerësoj zoti President në atë “Parlamentin vendor atje në qytetin e mrekullueshëm të Pogradecit” i cili nuk dallon nga Parlamentet në qyteteve të Evropës. ! Ky ishte “Mesazhi historik” që dha zoti President nga kjo vizitë zyrtare pune. Vizitë e cila duhet të bëhet program pune nga politikëbërësat në këtë vend. “Kjo Bashki e Këshilli Bashkiak i saj” duhet të kthehet në një “vend pelegrinazhi” për gjithë vendin. Ky është Mesazhi që duhet të lexohet prej të gjithë, “Parlamenteve vendorë e të gjithë Bashkive e Komunave të vendit dhe medemos Parlamentit i Shqipërisë” si shërbimin më të mirë që mund ti bëhet këtij vendi, Në se realisht të zgjedhurit e të gjitha

niveleve, dëshirojnë ta përmirësojnë punën e rezultatet e tyre në fushën e pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv. Mendoj, mediat duhet ta propagandojë këtë vizitë për të ndikuar realisht tek këto pushtete shtetërorë.

*** Pak histori për tolerancën, mirëkuptimin e besimeve fetare midis këtyre njerëzish !**

Gojdhana nga Mitologjia Ilire thotë se Pogradeci i sotëm është vendi i përzgjedhur i Zotit, ku Ai ngriti Tempullin e Fronin e vënd banimin e vet mbi këtë Tokë ! Dhe bekoj këtë popull që të jetojë me dashuri dhe në harmoni të plotë mes tyre. Zoti vetë” thonë “mbolli hardhinë e rrushit në këtë pellgun e Lyknidës duke i dhënë gjithçka që i duhej me bollëk për ta jetuar jetën si në një parajsë tokësore. Janë shumë fakte e arsye që mbase U. N. E. S. K. O duhet ta shpallë këtë Qytet “Kryeqytetin e Botës” qytet simbol, Embleme e Tolerancë e bashkëjetesës. Për ta afuar e sjellë në kohë e konkretizuar këtë mendësi po e ilustruj me shembuj:

Disa vite më parë shkrimtari i njohur Niko Nikolla përshëndetet me disa shokë e miq diku në ambientet e Bar Europa në Tiranë, ku dikush nga ai rreth shoqëror i thotë N. Nikollës se ai ishte i pa dëshirueshëm mbasi je me bindje të majta ! Po tha Nikolla është e vërtetë, por ne ndryshojmë të dy: Se unë shokun e mikun, nuk e zgjedh nga “Krahu”, por nga mëndja “Koka” kështu është dhe puna me Dashamir Shehin juve mendoni se je i një krahu me ata, por ai është më shumë shok e mik me mua, se ne na bashkon mëndja ! Kaq mjaftoj që ai shoku të dorëzohet dhe të ngrohej atmosfera.

Këngëtari jonë i madhi Sherif Merdani, gjatë verës të vitit 2010 ardhni në qytetin e Pogradecit për të dhënë një Koncert Recital së bashku me djalin e tij, student në artet për Violinist të cilët njohën sukses të plotë në atë koncert e bashkëbisedim të këndshëm me spektatorët e pranishëm, ku ai gjatë këtij koncerti gjeti kohën ta falënderonte Kryetarin e Bashkisë të ndodhur aty për një “diçka ndryshe, jo të zakonit sipas atij “ Duke ju drejtuar publikut ai tha : Para se ta jepja këtë koncert recital për ju, kisha një dilemë të madhe me veten time, mbasi më duhej të shkoja të merja konfirmim në Bashki në pushtetin vendor. I shkoj në zyrë zotit Shkëmbi për këtë problem me një farë ngurimi mbasi dikush, më tha se kjo është Bashki e majtë e besoj se do t’ju nxjerrë pengesa se juve jeni “Disident”?! por nuk ndodhi ashtu, zoti Shkëmbi më priti më shumë ngrohtësi, edukatë e rregullsi e më afrojt të gjitha lehtësitë e mundësime duke më uruar sukses të plotë për këtë Koncert. Dhe unë që kisha një ngurim nga kjo klimë e sjellje e politikës të ditës nuk kisha si të mos e falënderoja dhe ti “ Rëfe-

hesha “ për atë dilemë që më shqetësonte para asaj bisede

Më pas dëgjova prej tij, se unë gabohesha. Unë mësova, vijonin që udhëhiqej ai, Për ti shërbyet qytetarëve, për votësimin që atij i kishin dhënë, qytetarët e majtë e të djathtë për të qeverisur e për tu shërbyet të gjitha shtresave pa dallim besimi a bindje politike, Të cilin gjej rastin ta falënderoj dhe të shprehem se vetëm me të tillë nëpunësa, që afrojnë këtë shërbim mund të bëhet Shqipëria

* Vizita në Ekspozitën e piktorit Anastas Kostandini, konferencë për shtypin, bëra një xhiro në bulevardin kryesor e soditja e monumenteve të korifenjve të letrave të gjuhës shqipe dhe më pas u kalua në një drekë tek Bar -Restorant “Mileniumi” të ndodhur buzë liqenit në pikën turistike Tushemisht.

Pas takimit të punës, motiveve të cilat ishin e sollën zotin Presidenti në qytetin tonë, të cilat kanë për krye fjalë mesazhin e madh që i kërkohet politikës, për të ecur përpara. Mesazhi i zotit President: Për Tolerancë, Bashkëpunim, Dijë e Kulturë. Ky është çelësi i artë i zgjidhjeve të problemeve të mëdha të vendit.

Vizita e zotit Bamir Topi vazhdoi shumë njerëzor me takime të shumta me qytetarë, bashkëbisedime të lira urime për mirëseardhjen shtetngime pa fund nga zëmra duarsh, për të vazhduar me vizitën e Ekspozitës të Arteve Figurative të ndodhur në katin lart të bibliotekës së qytetit “Mitrush Kuteli” ku ai vlerësoj punën e madhe të Piktorit të Merituar, Anastas Kostandini në pasqyrimin mjesh-tëror në ato tabla të natyrës, traditës e shumë vlerave Kombëtare që ato bartin e pasqyrojnë. zoti President u përshëndet në ato ambiente nga ana e piktorit Kostandini në emër të pjesmarësve dhe artistëve pogradecarë duke i kërkuar zotit President të pranonte si kujtim një tablo me një pejsazh të bukur buzë liqenit, si fiksion për këtë vizitë mbresëlënëse

Në fjalën e tija më pas zoti Bamir falënderoj pjesmarësit për atmosferën shumë të ngrohtë e miqësore që gjeti nga pritja e përshëndetjet e shumë qytetarëve të pranishëm dhe vlerësoj këtë qytetari dhe vlerat që trasmeton kjo kulturë e qytetari ku ai u shpreh se nuk është rastësi nxjerrja e shumë figurave e personaliteteve të kombit nga ku qytet ku kujtoj dekretimin nga ana e institucionit të Presidentit të tre personaliteteve të vendit me titullin e lartë “Nderi i Kombit” dhe kujtoj Lagushin, M. Kutelin, Ing P. Pekmezi. e personalitete të tjerë që priten të vlerësohen.

Më pas, për zoti Bamir dhe stafin që e shoqërojnë ju ishte rezervuar një drekë në *Bar - Restorant - Mileniumi në fshatin turistik Tushemisht.

Koço PIHONI

SHOQATA "PELIONI" DHE STAFI GAZETËS "MOKRA" FESTON VITIN E RI-2011

Viti i ri festohet nga të gjithë popujt e botës. Ai sjell gëzime, takime dhe urime të përzemërta dhe ndryshime nga një vit në tjetrin.

Disa rriten, disa plaken, disa gëzohen dhe disa hidhërohen!. Por viti i ri festohet nga të gjitha nivelet nga çdo shtrese e popullsisë, shoqatate, stafe, dhe institucionet përkatëse.

Ishte 26 dhjetori 2010, Shoqata "Pelioni" dhe stafi gazetës "Mokra" u mboldhën dhe festuan vitin e ri 2011 në një nga ambientet e Tiranës. Ishin të ftuar, nga dega e Pogradecit nënkryetari i shoqatës Istref Haxhillari me bashkëshorten, dhe miku i mokrarrëve pa qënë në "mokrarr" dramaturgu Tomi Mato e tjerë.

Për punën një vjeçare të Shoqatës "Pelioni" foli kryetari i Shoqatës Pëllumb Zade. Ai vlerësoi punën e shoqatës, aktivitetet që ka kryer, takimet dhe organizimet e zhvilluara në Pogradec e Tiranë. Ndërsa Kryetari i nderit të Shoqatës "Pelioni" Haki Balliu, theksoi se në fillim e kishim shumë të vështirë, se si do të vpronte dhe oragnizohesh shoqata a' do të kemi anëtarë. Por po pate dëshirë dhe punove çdo gjë arrihet dhe bëhet më sëmiri. Sot nuk jemi në vitin 1999 kur e ngitëm, tani kemi dinjitet, kemi një histori disa vjeçare, kemi punën tonë.

Në takim u bënë shumë urime si nga Istref Haxhillari, Flori Slatina, Zabit Cuku, Sami Leka, Zenun Fero, etje. E veçanta ishte urimi dhe dollia e Tomi Matos. Ai erdhi direkt nga Pogradeci, vetëm për të festuar vitin e ri me Shoqatën "Pelioni" dhe theksoi se jam Mokrarr pa qënë "Mokrarr". Urime të shumta pati e dhe nëpërmjet telefonave nga zonat e thella të Mokrës e Pogradecit, Durrësit dhe Elbasanit, si Koço Pihoni, Bujar Balliu, Maliq Torra, Shefki Balliu, Isuf Çelbeqiri, Hamdi Krasta, Preng Reçi, Fadil Çoba, Ylli Xhelili, e shumë të tjerë të cilët nuk patën



mundësi të merrnin pjesë në këtë takim vjetor. Nga mezi i festës ndizet muhabeti dhe kënga nga dashamirësi i këngëve Zabit Cuku. Ky ka shumë këngë të preferuara por sot u këndua me shumë emocione të veçanta "Mikpritja Mokrare,,

*Nëpër dasma dhe gostira
Mokrari pi shëndet e ngre dollinë
O me çanak e pin rakinë
Pa dhe kenges kur ia merr
Iso mban tërë konaku
Gjithë shtëpia flakë nxjerr*

Kënga e bukur ndjek pa mbarimin nga Istref Haxhillari, Pëllumb Zade, Haki Balliu, dhe kënga qytetare e Pogradecit nga Tomi Mato. Me këtë rast nga stafi i gazetës "Mokra" u bënë dhe dërgon falenderime të shumë për të gjithë lexuesit, dhe dashamirësit e gazetës "Mokra" për përkrahjen, mbeshtjen dhe sponsorizue-

sit e saj. Për vitin 2011 do të jemi më kujdesshëm për ju. Problemet dhe propozimet tuaja do të përfaqësohen në gazetën "Mokra,, me dëshirën dhe punë nga të gjithë do të arrimë çdo gjë që duhet dhe është e domosdoshme. Asgjë nuk vjen vetë, populli thotë: "Hyzmeti-Kësmeiti". Respekti duhet, për këtë Çehovi thekson: Duhet të respektosh veten që të respektojnë të tjerët, tek njeriu duhet të jenë të gjitha të bukura, edhe shpërti, edhe muhabeti, edhe veshja edhe fytyra. Të studiojmë e mësojmë, po një mesazh thotë: se nga pangrëna mund të vdesin 20-30 shpirtëra, por nga pa dija vdes mëmëdheu me të gjitha,,

Shoqata dhe "Pelioni" dhe Stafi gazetës "Mokra" po punon për Mokrën, Pogradecin, dhe për vendlindjen me gjithë vësh-tërsitë që i janë krijuar. Gazeta "Mokra"

vazhdon rrugën e saj, nga krijimtaria dhe dalja e saj rregullisht për çdo muaj nga numri i parë e deri tani janë 144 numra. Kjo është e para punë e stafit por veçanërisht e kryeredaktorit Flori Slatinës (Balliu), më i përkushtuari, i pa lodhuri, më aktivisti dhe më i respektuari. Duhet të punojmë të gjithë për trevën, për vendlindjen për të shpalosur historinë, kulturën dhe traditën mokrare.

Një artitek shqiptar bëri shumë vepra artitektonike në Stamboll, por kur u kthye ne fshatin e tij e gjen të varfër. Po fshatarët i thonë se ti bëre një Stamboll, po për neve çfarë do të besh? Dhe arkitekti bëri një krua ku u quajt "Kroi i arkitektit". Pra mesazhi është se "kaq pati mundësi kaq bëri,,

Të rinjë e kanë lexuar novelën "Haxhiu i Frakullës" të autorit Vath Koreshi. Ai gënjehet nga një vajzë e bukur turke (Merexheja) e bija e një udhëtari të njohur turk. Djali nis për ta takuar vajzën në Samarkondë dhe arriti atje për tre vjet, ai e kuptoi se e kishte gënjyer. U kthye dhe kthimi qe i gjatë sa zgjati 23 vjet, se nuk kishte shpresë. U kthye me shpirt të gjymtuar, në vendlindje. I dukej sikur dëgjonte një këngë. Këtu ai njihte çdo gjë, çdo gur, dhe i çlodhej shpirti. Nga zemra i dilnin vargjet:

*Mos rend pas së kotës
Mos rend pas së huajës
Mos u gënjeni o djema
Këtë u'a them unë Haxhiu i Frakullës
Që u gënje nga gënjeshttra,,*

Kjo është një novelë, që shumë mokrarrë e kanë provuar se ç'është emigracioni. Vuajtjet e tyre. Por vetëm me punë është arritur qëllimit. Pra vetëm e vetëm një urim paçi o mokrarrë të nderuar kudo që jeni, shëndet, dëshirë dhe dëshirë për të punuar për vitin 2011. GËZUAR VITIN E RI 2011.

Zabit CUKU, Zenun FERRO

Nga MEVLUD BUCI

Ka shume vite që pata dëgjuar dhe lexuar për Mokrën dhe mokrarrët, ka shumë vite që njoh bijë të kësaj treve. Tek ata më ka lënë mbresa shpirtbardhësia, zelli i punës dhe bujaria. Që të tria vetëm e vetëm të çojnë tek fisnikëria njerëzore. Vendosa të shkruaj disa rrjeshta, "Mokra e fisnikërisë" Këta njerëz të thejshtë, e të mirë këta njerëz të respektuar, gjer në madhësi, që s'kanë nevojë për elozhe, e për suflerë, kurrë jo se marësinë e urtësinë i kanë në gen në reflektim, në punë e në mjedisin shoqëror. Elidi e ka detyrim shpirtëror ti përfalet mirënjohjes e fisnikërisë. Dhe ja një mëngjes dhjetori afër Kullës së Sahatit miku im Zenun Fero më dhuroi gazetën "Mokra". Unë i thashë: "ma thotë zemra e mendja i nderuar Zenun të shkruaj disa strofa, ose pak rrjeshta me titullin " Mokra e fisnikërisë" Miku im nënqeshi dhe pohoi se do ta botonte. Endjeva veten si

përpara një provimi serioz, përpara dekanatit ku tatohet pulësi i zotësisë, i djersës dhe përkushtimit. Faleminderit Zenun Feros, faleminderit Mokrës. I nderuari thonë brezat e të parëve dibranë-të nderon e të vlerëson. E ndiej sikur jam në shtigjet dhe odat e Mokrës, në mjedisin e valleve e të këngëve, përpara dëshimve të lartësisë së saj. Më shfaqet përpara Haki Slatina. "Mandela i Shqipërisë", kur dëgjoj zërin e tij, sikur shoh vuajtjet e persekutimit çnjerëzor, ndiej sikur jam përpara guximit të fisnikërisë shqiptare. Fjala e tij më ngjan me një përmendore lirie, më ngjan me Prometeun.. "Unë çuditë se si ka

qëndruar kaq shumë ky pushtet se një ditë do të përmbysset, sepse historia ka treguar se asnjë regjim nuk e ka mbajtur përherë pushtetin dhe as regjimi i Enver Hoxhes nuk ka për ta mbajtur përherë.., Njerëz me vizion, njerëz të lidhur me tokën, me kohën, me traditat, me fisnikërinë e brezave. Ndaloj para shkrimeve te Istref Haxhillarit ku midis të tjerave shkruan: Haki Balliu, me pamje dhe shprehjen e butë të portretit elegant gërmoi historinë e lashtë të dheut mokrarr nxori nga thellësia e kohës Dasaretët dhe kryeqendrën e tyre Pelionin e famshëm, ndër qytetet më të mëdha ilire,,...

S'kam si nuk gëdhend emrin e burrit të Mokrës Flori Slatina, poetit të dashurisë publicistit pendëndritur. Vërtet ndiej peshen e rëndë prej miku, prej vëllai, përpara shumë

gazetarëve mokrarrë. Emrat e tyre janë në mendjen time, ata më dhurojnë gjënë më të çmuar, fisnikërinë, dhe të tillë janë: Pëllumb Zade, Dhimitër Gegprifti, Zabit Cuku, Mine Fero, Sami Leka, Koço Pihoni, Xhevair Shtupa, Ramadan Gjata, Agim Gorica, apo të shquarit, Tomi Mato, Meri Lalaj, Kristaq Nanushi, e plotë të tjerë. S'mund të rri pa përmendur Velçanin fshatin e madh të Mokrës të shquarit Maliq Torra, Haki Balliu e Zabit Cuku. Tek lexoj një shkrim të Spase Thanasit përfaqem sepse ai lartëson me plot krenari e argumenta mokrarrë dhe gazetën "Mokra" që është për mokrarrët dhe gjithë shqiptarët: "Si një oaz vlerash etnografike kulturore dhe folklorike zona e Mokrës, njihet nëpërmjet librave të Haki Balliut, "Brikena e Pelionit" dhe "Rënia e Pelionit", ku bota e femrës mokrare del me virtutet më të larta e të plota në muzgun historik të kohës. "Ndryshe nga Elena e Trojes, fare ndryshe shkruan Haki Balliu, Brikena e Pelionit la peng vitet e rinisë për të sjellë paqe e marësi Enkelisë,, shkruan Hakiu duke gëdhendur e lartësuar vërtësinë e bukurisë.

Tek Bujar Balliu, Sami Leka, Meri Lalaj, Zabit Cuku e shumë të tjerë, Bedri Blloshmi Tomo Mato, Ben Andoni, Istref Haxhillari, Koço Pihoni, Herolinda Shullaku, Fari Bufi, Mina Daci, shkruajnë tek e nderuara "Mokra". Çdo toponim e emër në Mokrë çdo shkrim në faqen e kësaj gazete të ndritur sikur na çel një dritare fisnikërie. Njerëz të lartësisë, të qëndresës, të vuajtjeve, të begatisë njerëzore që rrezatojnë dritë demokracie, këta i ka lindur, mëkuar e rritur Mokra e Fisnikërisë.

URIME MOKRARËVE PËR VITIN E 13-TË TE GAZETËS

Një urim vjen nga zemra për ju dhe gazetën tuaj! Urim, e urime më të mira për vitin e 13-të, të Mokrës gazetë. Nga fillimi, e në vazhdim të pa shkëputur për ju kam një urim. Ashtu si vallja e bukur Rrajcare me zinxhir, pa këputur fare Ashtu qoftë edhe gazeta Mokrare. Pyes çdo ditë e çdo muaj kur del një fjalë e një lajm Një histori e barsalet në gazetën Mokra Urime dhe gëzuar me vite më të bukura!

ELSA CUKU,



INTERVISTË E AKADEMIKUT PROFESOR DOKTOR KOPI KYÇYKU, DHËNË GAZETARIT LLAZI TONA

Gabimet në politikë janë krime



Kam përballë akademikun pogradecar, mikun dijes, Kavalierin e Urdhërit të Shën Silvestrit, profesor doktor Kopi Kyçyku, një mesoburrë, me ballë të gjerë sokratik, me vështrim serioz, me pamje tipike intelektuale. Këtë e thonë edhe sytë e tij, lëvizjet energjike të duarve dhe mënyra e prerë e të folurit, përqendrimi i krejt qenies së tij. Akademiku Kopi Kyçyku, si enciklopedist që kërkon të dijë gjithçka, është kthyer në krenari, jo vetëm për vete, por krenari edhe për të tjerët. Me një veprimtari të gjerë dhe të thellë shkencore, ai nuk jeton vetëm për vete, por për njerëzimin.

Akademiku Kopi Kyçyku është futur thellë në labirintin e dijeve nëpër viset e Ballkanit, Evropës dhe botës. Kur e pyetën Aleksandrin e Madh të Maqedonisë: "Përse depërtove aq larg, deri në Indi?", ai u përgjigj: "Na thonë se qenkemi indoevropianë. Deri sa është kështu, atëhere kufijtë e Evropës mbarojnë në Indi". Edhe miku i dijes, akademikun Kopi Kyçyku, mbasi mbaroi një varg studimesh shkencore në shumë vende të Evropës, si: Rumani, Greqi, Kroaci, Bullgari, Maqedoni, Zvicër, Francë, Gjermani etj, shkoi për të hulumtuar në Turqi, në Indi e gjetkë. Mendja e ndritur, sjellja tepër njerëzore, vlerat morale dhe intelektuale, e ngritën në një pjedestal të lartë. Ai i ngjiti shkallët e lavdisë duke punuar si gjeolog, publicist, pushtetar vendor, deputet, shkrimtar, përkthyes, historian, mësimdhënës etj; kaloi gradat shkencore, që nga kandidat i shkencave, deri në doktor, profesor dhe akademik. Duke u nisur nga sa më sipër, mendova t'i marr një intervistë akademikut të mirënjohur, profesor doktor Kopi Kyçyku.

Llazi Tona: Vendlindja juaj është Pogradeci, ku ju përfunduat shkollën fillore dhe atë shtatëvjeçare. Cilat janë mbresat tuaja për to dhe për mësimdhënësit përkatës?

Akademiku Kopi Kyçyku: Edukatorë që fati e solli t'i njoh qysh në moshën më të brishtë, si Viktori Pihoni, e më pas Tushi Pasko, Dhimitër Tola, Spiro Angjele e të tjerë, ndikuan në formimin dhe ngulitjen tek unë, jo vetëm të njohurive të qëndrueshme në lëndë të ndryshme, por edhe të dashurisë e të krenarisë për vendlindjen e për vlerat e mirënjohura të kombit tonë.

- Edhe shkollën e mesme ju e mbaruat po në Pogradec. Sigurisht aty zhvilloheshin mësimet me një horizont më të gjerë; nxënësit formoheshin dhe fitonin dëftesën e pjekurisë. Cilat lëndë i vlerësonit më shumë dhe cilat nuk i nënvleftësonit?

- Pata fat që, fill pas mbarimit të shkollës shtatëvjeçare, në Pogradec çeli dyert gjimnazit "Reshit Çollaku". Ngjarje vërtet e rëndësishme për mua dhe për bashkëmoshatarët e mi, që dëshmonte ndërkaq se Pogradeci po çapitej me ritmin e duhur në rrugën e çelur nga bijtë e vet më të hershëm: Gjergj Pekmezi, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Pasko Milo e plot të tjerë: "Ku ka rrjedhur, do pikojë!"

Në qershor 1960, ne maturantët e parë ishim në gjendje të vlerësonim në shkollën e duhur punën e jashtëzakonshme që patën bërë me dhe për ne pedagogët tanë të mrekullueshëm Sotir Koci, Niko Mangoleci, Petro Prifti, Marko Salavaçi, Vangjel Marko, Nesti Bellovoda, Kozma Basho. Këtë emër të ndritur e përmenda në fund, - megjithatë meriton të vihet në ballë fare, - për të treguar një episod mbresëlënës. Pasi mora notën dhjetë në kimi, në të dy sesionet e provimeve, në vitin e parë të studimeve të larta, në Bukuresht, profesori i kësaj lënde, Andrei Hilzenrad, më tha: "Paska Shqipëria e vogël profesore kaq të mëdhenj, si ai që të ka përgatitur ty?"

Në gjimnaz, lëndët që më tërhiqnin më shumë ishin letërsia, gjuha shqipe, rusishtja dhe historia. Lëndët e tjera, jo se nuk i vlerësoja, por me to më shumë më afroje jo dëshira, por fakti që ishin të domosdoshme.

Profesioni që ëndërronit të kishit pas arsimin të lartë, a u realizua?

- Jo. Të tria kërkesat që parashtrrova u bënë jehonë dëshirave të mia për të ndjekur degë të fushës së letërsisë dhe të



gjuhëve të huaja. Bursa më doli për gjeokimi në Rumani. Pas një viti, për shkak të shkëputjes së regjimit të Tiranës nga tanku sovjetik, për t'u lidhur pas qerres aziatike, u ktheva në atdhe. Megjithatë m'u dha mundësia që paskëta të zgjidhja degën që dëshiroja, vendosa t'i përmbahesha një porosie të hershme të tim gjyshi: "Kur e fillon një punë, shpjegje gjer në fund". Nuk iu ndava, pra, gjeologjisë. Fakultetin e përfundova më 1965, me rezultate të larta. Më tej, kryerja pa shkëputje nga puna e Fakultetit Histori-Filologji (degët gjuhë-letërsi dhe histori), më ndihmoi të mos e braktisja ëndrrën e përhershme.

Cila ka qenë puna juaj e parë? Cilat janë mbresat që ju kanë mbetur? A ka ndonjë sekret puna juaj?

- Më 1965, fill pas mbarimit të Fakultetit Gjeologji-Miniera, fillova punën si inxhinier në ekipet e kërkim-zbulimit të kromiteve e të bakrit, në rrethet e Pogradecit e të Korçës. Teorikisht kisha formim të shëndoshë, por, për konkretizimin e tyre në rrafsh praktik, pra në terren, pata ndihmën e pakursyer të kolegëve më me përvojë, në radhë të parë të inxhinierit të talentuar e të palodhur Thimi Petro.

Pogradeci përfaqëson një ndër perlat e kulturës shqiptare, qytet i luleve dhe zonë e rëndësishme në Iliri. Ç'dini ju për enkleasit dhe dasaretët, pararendës të pogradecarëve të sotëm?

- Pyetja juaj parakupton një përgjigje

të hollësishme. Megjithatë, duke qenë se shumica e lexuesve, kush më shumë e kush më pak, e njohin çështjen, po mjaftohem me pohimin se qytetet e lashtë, që e qarkonin liqenin, - Lihnida, Enkelana, Beosa, Keraka, Sationa, - janë dëshmi e ekzistencës së një qytetërimi të lulëzuar në këtë "cep të Ilirisë së Poshtme", pjesë përbërëse e zhvillimit të vrrullshëm të mbarë Ilirisë.

Pogradeci nuk është vetëm qytet i turizmit, por edhe i minierave. Përse këto nuk ndihen më, aq sa minatorët veterani shprehën me dhembje: "Kanë rënë në gjumë të thellë". Cili është mendimi juaj, si specialist i gjeologjisë?

- Pogradeci është qytet i luleve, por edhe qytet zemër-hekur. Në gjatë të tij, siç e përmendët edhe ju, "strehohen" thesare të tejçmuara: vendburime hekur-nikeli dhe kromi, qymyrguri etj. Madje ekzistojnë parakushtet për zbulimin e vendburimeve të xeherorëve të tjerë, si të bakrit e të polimetaleve. Por edhe të pasurimit të tyre me metoda mekanike, kimike etj, sidomos në kushtet e sotme, kur teknologjia përkatëse ka përparuar jashtë

nga A. Lakçe. Detyra themelore që i vunë vetes atdhetarët ishte njësimi me lëvizjen e përgjithshme të popujve të tjerë të Ballkanit për flakjen tej të robërisë otomane. Për fat të keq, qysh në hapat e para, me sa duket për shkak të veprimtarisë minuese të të huajve, në gjatë drejtuesve të "Dritës" u shfaqën shënja përçarjeje, çka çoi në formimin e dy rrymave kundërvënëse. Si rrjedhojë, u ngjiz një shoqëri tjetër e pavarur, "Diturija". Ndërkaq, tash e tutje, "Drita" do të vihej mbi themele të shëndosha nga Nikolla Naço. Për të pasur hapësirë më të gjerë veprimi, Nikolla Naço, që shquhej për atdhetarizëm të pastër, mprehtësi, kthjelltësi mendimesh, zhërvjelltësi dhe shpirt ndërmarrës, bëri për vete dhe siguroi mbështetjen e mjaft personaliteteve rumune, që, krahas mbrojtjes së kauzës së popullit të tyre, ushqenin simpati për popullin shqiptar. Të tillë ishin: V.A. Ureke, D. Butkulesku, Leonte, M. Dëshliu. Më 1889, Nikolla Naço, duke u bërë drejtues i mbarëpranuar i Shoqërisë "Drita", i dëndësoi dhe i diversifikoi aksionet në të mirë të kombit tonë, duke i bërë botërisht të njohura aspiratat dhe vlerat qytetëruese të shqiptarëve. Nikolla Naço shkriu krejt pasurinë e vënë me djersë e mund në vite, për çështjen kombëtare.

- Por, si shpjegohet që Nikolla Naços, këtij apostulli të shqiptarizmit, me prejardhje nga Podkoczani i Mokrës së Sipërme, që ka bërë aq shumë për zgjimin e popullit shqiptar dhe për Shpalljen e Pavarësisë, nuk i është bërë asnjë nderim në Shqipëri? Nuk i është dhënë, bie fjala, titulli "Nderi i Kombit"?

- Keni plotësisht të drejtë që e ngrini këtë çështje. Përveç një monografie shkencore serioze dhe gjithëpërfshirëse kushtuar figurës dhe veprës madhore të Nikolla Naços, shkruar nga profesori kosovar Ismet Dërmaku, kurrujt tjetër nuk i ka shkruar ndërmend t'i japë atë që meriton këtij personaliteti të shquar. Vërtet është për të ardhur keq. Këtu ka dy gjëra: autoritetet shtetërore o nuk e njohin këtë figurë dhe lipset t'ia hyjnë punës hulumtuese-informuese për një gjatë të tillë; o e njohin dhe e shpërfillin. Uroj që kjo e dyta të mos ekzistojë, se, ndryshe, do të duhej të vinim duart në kokë nga tronditja.

- Ndër veprat e shumta letrare dhe shkencore, ju keni botuar edhe librin "Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik", që është mirëpritur nga vllahët apo armënjët e Shqipërisë.

Për këta, sot qarkullojnë disa terma: vllah përdoret në Sërbë, në Maqedoni dhe në Shqipëri. Në shqip të kujton fjalën vëlla. Gjermanët i quajnë velchi, term që u jepet popujve me zanafillë latine; historiografët bizantinë i thërresin moes ose musin, që vjen nga Moesia e Vjetër, trevë, ku stërgjyshët e vllahëve bashkëjetuan me popuj të tjerë. Hasim edhe emërtimin cëncar, që në gjuhët sllave ka kuptimin bir mbreti, çka të çon në prejardhjen e tyre mbretërore, nga Aleksandri i Madh. Në vitin 212, perandori romak i quajti të gjithë nënshtetasit e vet të Lindjes romunus ose romei. Grekët cilësohen si zbulues të arteve dhe të shkencës; trakët si mësimdhënësit e parë të filantropisë dhe të arteve të bukura. Në shekuj Gadishulli i Ballkanit ka qenë i banuar nga trakët, persët, ilirët dhe grekët. Sipas Thunmann (1774), shqiptarët dhe vllahët apo armënjët janë popujt më të vjetër të Evropës. Injë mendjeje është edhe antropologu grek A.M. Poulinos, i cili ka vënë në dukje se vllahët janë një popull paraindoevropian. Homeri i famshëm përmend termin armënj, që mund të vijë nga are = ka dhe mënjë = duar. Si Homeri, ashtu edhe Herodoti, në veprat e

tyre theksojnë se armënjët banonin në Azinë e Vogël e në Trakë, rrjedhin nga pellazgët dhe, bashkë me popujt e tjerë bashkëjetues – grekët dhe ilirët, përdornin një gjuhë të përzier. Ju me cilin mendim jeni?

Në librin tim, që e zutë në gojë në fillim të pyetjes suaj, sidhe në librin tjetër, të mëvonshëm - "Arumunët në optikën shqiptaro-rumune", - kam parashtruar dhe zbërthyer me sy kritik tezat e shumë shkollave perëndimore e lindore; në veçanti opinionet e studiuesve rumunë, arumunë e grekë, që përplasen dendur mesveti, duke u njësuar jo rrallë me përfundime të skajshme. Një gjë është e pamohueshme: arumunët përfaqësojnë një etni që shquhet për virtyte të panumurta, luftëtarë të paepur, art e dijedashës të dalluar, që, gjatë historisë shumëshekullore, kanë shërbyer si element stabiliteti dhe progresi në shkallë kontinentale dhe më gjerë, duke dhënë kontribut të çmuar për fitoren e lirisë dhe pavarësisë së vendeve dhe popujve me të cilët kanë bashkëjetuar në paqe dhe mirëkuptim shëmbullor. Dëshmi bindëse përta më sipër, janë marrëdhëniet e ngushta, vllazërore të shqiptarëve me arumunët.

Në dritën e të dhënave që kam qëmtuar e gjetur në arkivat e shumë vendeve të botës, përfshi edhe ato të Selisë së Shënjtë, qysh më 1998 kam dalë në disa përfundime, ndër të cilat më lejoni të veçoj:

1. Arumunët, - vllahë, kucovllahë, sarakacanë, cëncarë, vllasë, rëmënj etj, - përfaqësojnë mbijetimin e një popullsie nga më të hershmet në kontinentin evropian.

2. Historia e arumunëve dëshmon për një prani të pandërprerë të tyre në hapësirën ku janë ngjizur, pra në Gadishullin e Ballkanit.

3. Drejtimit themelore të hulumtimeve të ndërmarra nga një numur i madh shkencëtarësh e studiuesish nga vende të ndryshme të botës, kanë synuar në radhë të parë:

a. Vlerësimin e antropologjisë kulturore dhe identifikimin e disa llojesh qytetërimi, që kanë karakterizuar njerëzimin e, në këtë kontekst, edhe qytetërimin arumun: baritor e bujqësor, nomad, urban, detar, tregtar etj, që nisin nga kohët më të hershme dhe vazhdojnë deri në ditët tona;

b. Identifikimin e vllahëve, që më pas do të quheshin edhe arumunë, si bartës të një qytetërimi të pasur e si një popullsi që ka mbijetuar deri më sot. Një hollësi: a-ja nuk është zanore mohuese, por zanore që përdoret shpesh në të folmen e vllahëve. Një shëmbull: në vend të fjalës rumune *râu* (lumë), arumunët përdorin fjalën *arâu*;

c. Mbijetimin e arumunëve falë mënyrës së jetesës në majmale dhe në pllaja - streha të paprekshme dhe veçorizuese të qytetërimit të arumunëve;

ç. Njësimin e vllahëve me pellazgët, që përfaqësojnë protoindoevropianët e përhapur në krejt Evropën në mijëvjets-hat VI dhe V para Krishtit;

d. Historia e mesjetës bizantine dhe e periudhave të mëvonshme (sundimi osman, shtetet kombëtare të krijuar mbi gërmadhat e Perandorisë Otomane), dëshmon për praninë e pandërprerë të popullsisë arumune në mbarë Gadishullin e Ballkanit;

dh. Specifika e arumunëve si entitet më vete provohet nga gjuha, zakonet, doket, traditat e ritet e tyre të motmotit. Këto flasin për lashtësinë dhe kulturën origjinale të arumunëve;

e. Popullsinë arumune e kanë kanosur vazhdimisht rreziqet e akulturimit dhe të përthithjes. Por, në kushtet e demokratizimit të jetës në të gjitha vendet e Ballkanit, ku jetojnë arumunë, sidhe të devizës së Evropës së Bashkuar: "Unitet në diversitet", duhen bërë përpjekjet e nevojshme dhe duhen hedhur hapat e duhur për një afirmim të mirëfilltë të arumunëve në rajonin tonë;

f. Arumunët e Shqipërisë, përveç simpatisë së veçantë tradicionale nga ana e popullit shqiptar, tani gëzojnë edhe përkrahjen e madhe të shtetit tonë demokratik, çka garanton plotësimin shkallë-shkallë të të gjitha kërkesave të drejta



të arumunëve, në pajtim me ligjet tona dhe parimet e bashkësisë ndërkombëtare.

- **Ç'është për ju letërsia?**

Termi "letërsi" ka domethënie të ndryshme, në varësi nga konteksti në të cilin përdoret. Dijetari dhe filozofi Imam Ja'far al-Sadik (702-765) jep këtë përkufizim: "Letërsia është rrobja që dikush, i cili shkruan, ia vesh asaj që shkruan që të duket sa më tërheqëse". Gjithsesi, letërsia është një copëz e jetës, që këqyr dhe interpreton artistikisht çdo dukuri. Ajo mund të quhet edhe art, që ka si mjet fjalën e shkruar. Për mua letërsia përbën edhe një mundësi pa të dytë për të shprehur atë që ndjeh për gjithçka më rrethon.

- **Po kritika letrare?**

- Me kritikë letrare nënkuptohen studimi, zbërthimi, vlerësimi dhe interpretimi i teksteve letrare. Praktikimi i kritikës letrare u shndrrua në profesion vetëm në shekullin XX, por rrënjët e saj vijnë nga Greqia dhe Roma e lashtë. Kritika letrare përdor një sërë termash specifikë, metalinguistikë, shumë prej të cilëve datojnë pë nga periudha e antikitetit. Me sa po shohim, kritika letrare çapitet në dy hulli: njëra e cekët, "qejfmosprishëse", "aminolare", ndërsa tjetra - akademike, e thellë, e paanshme. E dyta parakupton përgatitje të gjithanshme teorike, studim të zellshëm, seriozitet, çka, mjerisht, nuk u shkon për hosh shumicës së atyre që pretendojnë të formulojnë gjykime për veprat letrare të mirëfillta dhe t'u hapin horizontet krijuese dhe lexuesve.

- **Një fakt shqetësues - në Shqipëri leximi i librit ka rënë shumë. Pse ndodh një gjë e tillë?**

- Do ta nis përgjigjen disi ndryshe. Ngurrimi për të lexuar varet nga një fragment i ADN-së. Ky është përfundimi në të cilin kanë dalë hulumtuesit e universitetit britanik të Oksfordit. Pra, qëndrimi ndaj leximit qenka i lidhur me një gen, i cili, fatmirësisht, nuk ushtroka kurrfarë ndikimi mbi koeficientin e inteligjencës. Gjithsa thamë është e vlefshme në shkallë botërore. Por, në rastin tonë, fajin për rënie drastike të numurit të lexuesve na e kanë në radhë të parë disa faktorë që varen kryekëput nga vetë ne. Leximi lyp përqendrim, jo shkuajdesje - veçori e televizorit apo e zbatimjeve gjithfarësh. Varfërimi shpirtëror masiv, për shkak të lakmisë për t'u pasuruar materialisht, i bën njerëzit ta venë stomakun para zemrës; trurin "matematik" para shpirtit ëndërrues. Më tej: cilësia e dobët artistike, mungesa e vlerave shkencore, ngushtësia tematike, shtimi i radhëve të "krijuesve" me paralinj etj, ndikon jo pak në largimin nga

libri. Edhe interneti ka rolin e vet frenues. Sido që të jetë, libri i shkruar, "i gjallë", nuk ka për të "vdekur" kurrë, ashtu sikurse pllakat e gramafonit nuk mund "të mposhten" nga CD-të e trajta të tjera, pjella të teknologjive moderne.

- **Në Bulevardin Evropë në Pogradec janë pasqyruar njëqind figurat e shquara të kontinentit tonë. Ndër to janë edhe dy heronj: Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe Janosh Huniadi. Përse vetëm këta dhe jo të tjerë?**

- Së pari, në përzgjedhjen e figurave që sapo përmendët, nuk janë ndjekur kritere shkencore. Përveç empirizmit të pafalshëm, pasaktësitë e shkallëve të ndryshme janë të shumta, madje shqetësuese. Listën e gabimeve, gafave dhe mangësive, e kam dorëzuar në Bashkinë e qytetit qysh vitin e kaluar. Moskokëçarja e shfaqur në këtë rast nga seksioni përkatës është të paktën e habitshme.

- **Cilin frut shijoni më shumë?**

- Me frutat është si me lulet. Sado i bukur të jetë një trëndafil, nuk ka se si të krahasohet me një buqetë të përbërë nga karafilë, borzilokë, shebojë, gojasllan etj, që, përveç larmisë së ngjyrave, përhapin edhe aroma të ndryshme.

- **Publicisti dhe prozatori i madh shqiptar Faik Konica, ka thënë: "Shqipërinë e bënë rilindësit, por e prishën politikanët".**

- Gabimet në politikë janë krime. Nëqoftëse nuk je i zoti për një punë, le të vuajë familja jote. Gjynah për të, por kështu i "qenka shkruar". Por jo të vuajë një popull të tërë. I madhi Faik Konica ka plotësisht të drejtë se, gabimet e politikanëve të paafatë, të pandershëm, apo të dyja bashkë, të paktën frenojnë zhvillimin e një vendi dhe e errësojnë perspektivën e tij për dekada, në mos po edhe për periudha më të gjata. "Më mirë të dish se sa të kesh" na mëson mençuria popullore.

- **Në veprën e vet "Nata e dymbëdhjetë", Uilliam Shekspiri ka shkruar: Ç'vend është ky, o miq? / Kjo është Iliria, zonjë. / E njihni ju këtë vend? / Po, zonjë, e njoh mirë. A e njihet vërtet Shekspiri Ilirinë?**

- Besoj se po. Të paktën për dy arsye: së pari, prej katër vargjeve që cituat nga vepra e dramaturgut të madh anglez, del qartë një përfundim i tillë; së dyti, Iliria nuk ishte një nocion thjesht gjeografik, por bartëse vlerash kulturore dhe qytetëruese të pakontestueshme, të cilat një intelektual i shquar, si Shekspiri, nuk kish se si të mos i njihje.

- **Nga pijet "burrërore", cilën parapëlqeni më shumë: vodkën Gorbaçov, uzon greke Metaks, apo rakinë shqiptare?**

- Pijen ngadhnyese - konjakun Skënderbeg, i cili e ka mundur Napoleo-

nin (konjakun) mu në Paris! Madje jo vetëm një herë!

- **Ç'është për ju Enciklopedia Akademike?**

- Enciklopedia është një punim leksikografik i njohurive dhe i dijeve njerëzore, i shkruar e i pasuruar në mënyrë sistematike. Ky term e ka zanafillën nga greqishtja (*enkylios paideia* - "në një rreth të dijes"). Dihet se enciklopeditë mund të jenë të përgjithshme, pra që përmbajnë materiale nga të gjitha fushat (për shëmbull Enciklopedia Britannica), ose të specializuara në një lëmë të caktuar (në muzikë, në fizikë etj). Ka edhe enciklopedi me larmi fushash të vetëm një vendi apo kulture (Enciklopedia e Madhe Sovjetike apo Rocarta). Megjithatë punime enciklopedike janë shkruar gjatë periudhave të ndryshme të historisë së njerëzimit, termi "enciklopedi" filloi të përdoret vetëm në shekullin XVI.

- **Vitet e fundit, në mjediset krijuese bien në sy shfaqja të vetëmburrjes. Kështu, ka ndonjë shkrimtar që, me të botuar librin e parë, me zë të lartë e quan veten "njeri i letrave", apo nuk le njeri pa kapur që të shkruajnë në gazeta e revista artikuj ose recensione lavdëruese për të. Madje shkojnë edhe më tej: mbushin organet e shtypit me materiale, me anën e të cilave orvaten ta krahasojnë veten me nobelistë dhe, njëherazi, deklarojnë se koha e Lasgushit dhe e Mitrush Kutelit ka ikur; janë demoduar. Tani, sipas tyre, vendi i nderit u takon shkrimtarëve të rinj, "modernë".**

- Një nga mallkimet më të rënda popullore është: "Të hyftë vetja në qejf!". Nga ai çast ze fill rrokullima, gremisja drejt honit - pikëmbërritja fundore e dështakëve megallonant, që vuajnë nga sëmundja e pashërueshme e amokut.

- **Mjerisht ka mjaft individë të përgjegjshëm, që e nënvleftësojnë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri. Disa arrijnë deri atje sa të shprehen se në vendin tonë nuk është bërë luftë ose, edhe në është bërë, paska qenë luftë civile. Cili është mendimi juaj?**

- E kam theksuar edhe herë tjetër se masmedia e shkruar dhe elektronike jo rrallë na rrëfen jo histori, por historira, meselera nga më të habitshmet, për të mos thënë nga më të përbindshmet. Në një kohë që është pranuar zyrtarisht, shkencërisht e ndërkombëtarisht se, për nga sipërfaqja dhe numuri i banorëve, Shqipëria radhitet ndër vendet me ndihmesë më të madhe në luftën antifashiste të njerëzimit dhe në një kohë kur shtete të tjerë, ish-aleatë të nazifashizmit, bëjnë çmos ta fshijnë apo, të paktën, ta zbehin këtë njollë turpi, madje, në ndonjë rast, ta heqin veten si antihitlerianë, segmente të caktuara të propagandës e të mjeteve tona të informimit masiv bëjnë të kundërtën: përbaltin historinë e vërtetë. Fakti që në çdo kilometër katror të Shqipërisë ka rënë nga një dëshmor, është nder për mbarë kombin, çka nuk mund të monopolizohet nga asnjë parti, apo qeveri. Luftëtarët që dolën malit, - komunistë, ballistë, nacionalistë, zogistë, - shumica të rinj që kishin fare pak, ose aspak njohuri për politikën, i frymëzonte fitorja e lirisë dhe dëbimi i pushuesve të huaj nga trualli i atdheut. Ata nuk dinin se ç'mund të luhej në kurrizin e tyre dhe të një populli të tërë nën parullat "Pa dallim feje, krahine dhe ideje", apo "Të gjitha çështjet do t'i zgjidhim pas luftës, pas shporrjes së okupatorit". Madje, jo rastësisht, partia komuniste, fjala vjen, nuk guxoi të dilte hapur, por, edhe pas përfundimit të luftës, vazhdoi për një farë periudhe të fshihej pas maskës së Frontit. Fakti që mijra djem e vajza dhanë jetën në emër të lirisë, në lulen e moshës, na bën të nderojmë siç na ka hije vetmohimin dhe veprën e tyre. Ndërkaq është fat që "autogoli" i pafalshëm me librin e parë të kombit, pra me historinë, nuk është përsëritur nga masmediat shqiptare duke "vërë dorë" në vlerat e folklorit, muzikës e përgjithësisht të traditave tona shumëshekullore. Ndryshe do të zgjonin mallkimin stërgjyshor... (vijon në faqen 6)

SHËNIME PËR LIBRIN "HISTORIA E LUFTËS-KOSOVË-NATO-SHQIPËRI" TË N/KOLONEL ZENUN FEROS

Epopeja e lavdishme e Luftës së Kosovës

Nga Haki BALLIU

Publicisti tanimë i mirënjohur, Zenun Fero, na befason me librin e tij të tretë "Historia e Luftës Kosovë-Nato-Shqipëri". Më së pari autorin e admiroi për vullnetin dhe kontributin e tij në fushën e historisë së artit ushtarak shqiptar. Më parë botimi i librit "Artileria Shqiptare" e tani vështrimi mbi Luftën e Kosovës, janë pasuri që rrallë kush na i sjell. Madje dhe libri "Slabinja e Jonë", ashtu si dhjetëra artikuj në organet e shtypit ushtarak, janë plot ngjarje nga luftërat e së shkuarës.


E përsëris, se autori është një studiues i zellshëm. Sigurisht ka një favor, qenien e tij si ushtarak i karrierës me gradën e n/kolonelit. Të tillë unë njoh me dhjetëra e shumë, por nuk kanë shkruar sepse ju mungon vullneti dhe përkushtimi e aftësia që ka Zenuni. Pa i bërë opionencë librit në fjalë, gjë e cila u takon akademikve ushtarakë, kam fatin ta studioj Zenon si një regjistruer të përpiktë të rrethanave dhe ngjarjeve, të cilat fillojnë me organizimin ushtarak të frontit të rezistencës kosovare, masakrat serbe, ndërhyrjet e NATO-s e deri në ditën e bardhë të qershorit, kur koha e ndaloi luftën.

Po të lexosh librin do të shohësh se ç'punë e kujdeshme dhe aq e lodhshme ka bërë autori. Lexuesi i vëmendshëm ndoshta kujton botimin e gazetës "Mokra" në marsin e 1999, kur një elitë e vogël intelektualësh solli në vëmendje të bashkëkrahinasve shkrimin me titull "Tragjedia e Kosovës Mokrare e ka përjetuar 80 vite



të shkuara. N/kolonel Fero i ndiqte zhvillimet direkte nga fronti i luftës në konsulencë me shtabin e Përgjithshëm të FASH dhe ushtarakët e tjerë të NATO-s. Mbase pa e menduar se një ditë autori do t'i mblidhte këto shënime në një libër, ai jo vetëm ndiqte situatat por mbante ditar. Madje këto pasuri me të dhëna nga arkiva e shtabit të Përgjithshëm të FASH, nga shtypi legal dhe referencat e librit të gjeneral Kudisi Lama, Jakup Krasniqi e tjerë.

Kronologjia e ngjarjeve është e vendosur me kujdes. Autori nuk bën komente, sepse përpara fakteve ato nuk i duhen. Ai është sa i përkushtuar aq dhe i përpiktë me datat, emrat raportin e forcave, kalibrat dhe sasinë e armëve të cilat janë profesioni i tij e tjera. Libri fillon e bëhet tërheqës kapitull pas çdo kapitulli, ashtu siç rritet shpirti luftarak i popullit kosovar nga demonstratat e vitit 1981 e deri tek krijimi i UÇK-së. Autori nuk "vrapon" drejt e tek fitorja përfundimtare. Ai fillon me dhim-



Kopertina e librit të Zenun Feros

bjen mizore mbi popullsinë kosovare. Teksa lexon 22 masakrat që përshkruan autori, rrëqethesh, mëshiron viktimat dhe urren mizorisht skenat, barbare të ushtrisë serbe mbi popullsinë e pambrojtur kosovare. Këto jepen të plota: vendi, krimi, forca ushtarake numri i viktimave. Këto shpesh të shoqëruara me emrat e tyre.

E shoh të tepërt të jap përshtypjet e mia për çdo kapitull. Po në dy kapitujt e fundit 7-8, se lexuesi i Shqipërisë mëmë do ta gjejë veten e tij. Në Operacionin "Shigjeta", i cili ndaloi mësymjen e ushtrisë serbe nëpërmjet tokës shqiptare për krahëmarrje ndaj UÇK-së, futen në luftim Divizioni jonë i Kukësit, i komanduar nga gjeneral

Kudsi Lama. Sigurisht suksesin e solli faktori njeri. Aleat i ngushtë ishte terreni i fortifikuar dhe artileria. Zenuni jep domethënie thënies së gjeneralit të tij. Fal fortifikimit, forcat tona dolën pa humbje në njerëz përballë predhave serbe. Nga ana e jonë artileria kishte aq gryka dhe fuqi zjarri sa "çdo serb të vritej me nëntë predha". Së fundi shume kujt si unë, do t'i kenë dalë nga kujtesa 63 luftëtarë shqiptarë që dhanë jetën për Kosovën dhe 11 të tjerë i kemi invalidë akoma. Fatmirësisht emrat e tyre i gjejmë në faqet 254-257 të librit dhe u kthyen në Shqipëri. Po thuaj të gjithë këta ishin oficerë të kapur nga reforma ushtarake. Kjo është sfida që i bëjnë shtetit njerëzit me uniformë. Për autorin e librit do të ishte sukses i dyti nëse do t'u kushtonte një tjetër libër këtyre martirëve të lënë në harresë.

Gjithsesi trioja e Zenun Feros "KOSOVË-NATO-SHQIPËRI", përbën një lidhje domethënëse që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që s'do të ngjallehin pa njëra-tjetrën. Ndërkohë libri ka vlera të veçanta akademike për historinë e artit ushtarak. Njëherësh mund të vlejë si libër Shkollor. Brezat nuk duhet të harrojnë krimet serbomane, të cilët me mizoritë e viteve 1998-1999 treguan dhe një herë shkjarinë e vjetër. Për derisa deklarohen gjer në dyert e Evropës, se pavarësinë e Kosovës s'do ta "njohin kurrë", do të thotë se shpirti i tyre nuk pastrohet nga ndryshku i vjetër. Të mos harrosh është qytetari. Ky është mesazhi që na përcjell autori. Fatmirësisht një ushtarak dinjitoz, URIME!

INTERVISTË E AKADEMIKUT PROFESOR, DOKTOR KOPI KYÇYKU

(vijon nga faqja 5)

- Një grup nismëtarësh, i përbërë nga Haki Balliu (oficer në pension), Flori Slatina (gayetar), Bajram Balla (oficer në pension), Pasko Vako (ekonomist, doktor i shkencave), Isa Gorica (profesor) dhe unë (oficer në pension), kanë themeluar shoqatën e krahinës së Mokrës, me emrin "Pelion". A ju duket me vend një gjë e tillë?

- Sigurisht. Fenomeni Mokër, djep i kulturës së lashtë, që ka hyrë me dinjitet në histori të paktën qysh në kohën e Skënderbeut, meriton të bëhet i njohur brenda e jashtë vendit, si model i ndritur mbarëkombëtar, me rrezatim në botë. Këtë mision "Pelioni" do ta përmbushë më së miri. Mjaft të shohim emrat e mirënjohur të themeluesve të tij.

- Çfarë keni shkruar kohët e fundit?

- Disa monografi për figura të shquara të popujve evropianë dhe kaukazanë, dhe historinë e vendeve të ndryshëm (në rumanisht), sidhe tre tekste universitare. Kam shkruar edhe dy monografi (në shqip): njëren për pionierin e regjisurës profesionale të Kosovës, të ndjerin Besim Sahatçiu (me rastin e 75-vjetorit të lindjes së tij) dhe tjetrën për jetën dhe veprimtarinë atdhetare dhe kulturore-shkencore të luftëtarit të shquar antifashist, intele-

ktualit evropian, Astrit Leka. Ndërkohë jam duke vazhduar me shkrimin e një punimi prej rreth një mijë faqesh që ka në qendër përbashkësinë e traditave dhe të dokeve të popujve që janë ngjizur dhe jetojnë në zona të ndryshme të rruzullit tokësor. Kohët e fundit kam përkthyer nga shqipja në rumanisht vëllime të poetëve tanë më të njohur, si Agim Vinca etj, dhe më pak të njohur, si Irini Nanushi etj. Nga rumanishtja kam shqipëruar një vëllim të poetit Vasile Taraceanu, që jeton në Bukovinë (Ukrainë), sidhe dy poetë turq: Tahsin Saraç dhe Qemal Bajram.

Cilat janë gjërat që i vlerësoni më shumë në jetë?

Mbajtja e fjalës së dhënë, guximi për të njohur të metat, atdhedashuria, krenaria që jam shqiptar.

Çfarë roli ka luajtur bashkëshortja në jetën tuaj?

Bashkëshorte besnike, amvisë dhe mirëritse e fëmijëve, që më ka qëndruar pranë pa rezerva edhe në momentet më të vështira të jetës.

Kë do të veçonit si pjesën më të bukur të jetës suaj?

Vitet e fëmijërisë dhe të gjimnazit. Djemtë tuaj a po ndjekin rrugën e babait?

Djali i madh, Ardiani, të cilin e njihni dhe e keni intervistuar, ka kohë që ma kaluar në lëmin e krijimtarisë letrare. Jam krenar që, krahas shqipes, shkruan me të njëjtën lehtësi edhe në rumanisht. Dhe në nivel të lartë, çka shpjegon përkritika e specializuar e ka cilësuar një nga tri penat më të fuqishme të gjuhës rumune. Më i vogli, Gentiani, është jurist dhe mëson me lehtësi gjuhë të huaja.

Në kohën e lirë me se merret profesor Kopi? Lexon gazeta apo libra; dëgjon muzikë, ndjek sportin, apo luan shah e tavell?

Të gjitha i bëj, me përjashtim të tavellës, të cilën nuk e kam mësuar.

Cili është ushqimi që parapëlqeni?

Çdo ushqim, në të cilin futet luga, pra i lëngët.

Ditët më të vështira për ju?

Ato të verës 1981, kur trashja Javer Malo-Ferdi Karagjozi-Ymer Minxhozi sajoi një intrigë, sa qesharake, aq edhe të neveritshme dhe të rrezikshme.

Çfarë veshje ju pëlqen?

Ato që pranojnë vënien e kravatës.

Si është jeta në Rumani?

Pak a shumë si në Shqipëri, prandaj edhe i jemi përshtatur pa vështirësi.

Para disa ditësh morët pjesë në veprimtaritë e organizuara për kremtimin e Ditës

së Verës. Ç'mbresa ju la kjo ngjarje, tashmë tradicionale?

Të them të drejtën, i nderuari zoti Llazi, u preka thellë, se salla e Hotelit Enkelana i ngjante një Pogradeci në miniaturë. Gjithçka: butet me verë të kuqe e të bardhë, dollitë, këngët e vallet, recitimet, fjalët përshëndetëse..., ma zgjuan kujtesën në vitet e fëmijërisë e të rinisë sime, dëshmitare të solidaritetit e të mirëkuptimit shëmbullor midis banorëve. Por edhe mikpritjen bujare të tyre për të ardhurit nga vise të tjera. Këtë ndjesi pata kur pashë ngrohtësinë me të cilën u trajtua aktori dhe regjisori i madh Rikard Ljarja, që kish ardhur me bashkëshorten, artisten e mirënjohur Marjetën, qytetare nderi e Pogradecit; apo i tejtalentuari dhe fisniku Mevlan Shanaj, i cili, gjithashtu, kish në krah bashkëshorten, poeten e shquar Natasha Lakon. Të gjithë janë bërë dashamirës e miq të qytetit tonë.

Mesazhi juaj për Pogradecin në përgjithësi dhe për Mokër në veçanti.

Më lejoni ta mbyll me humor, me një perifrastim: "Kur themi Mokër nënkuptojmë Pogradecin dhe kur themi Pogradec nënkuptojmë Mokër. Prandaj edhe mesazhi është i njëjtë: Uroj që këta dy emra të gëzojnë në shekuj respektin dhe mirënjohjen plotësisht të merituar të njerëzve!

Intervistoi: Llazi TONA

Ah, moj Mokër!

Nga Agron MEÇAJ

Kam lindur në Tepe lenë në vitin 1953. në vitin 1972 kam përfunduar shkollën ushtarake Skënderbej me rezultate të shkëlqyera. Dhe për këto rezultate mu dha e drejta që të vazhdoja universitetin e Tiranës në degën Gjellogji Miniera.

Si gjeolog kam punuar 33 vjet në Pukë, Kukës, Has, Peshkopë, Bulqizë, Valias, Mushqeta dhe Dajt. Kam punuar në ndërtimin e hidrocentraleve të Holtës, Gramsh dhe Bishnicë Mokër.

Por për këto që kam lëvizur dhe kam kaluar mbresa më ka lënë Mokra për të cilën dua ta kujtoj me disa rrjeshta

AH MOJ MOKËR

Të shkosh në Mokër, pasi të keshë mësuar mirë historinë e

lashtë dhe të re të krahinës, do të ndjesh një farë zhgënjimi të madh. Fajin nuk e kanë banorët. Ata janë njerëz të mrekullueshëm, ta dashur, punëtorë, e mikëpritës. E duan tokën, bimët, kafshët, Bile për kafshët jam çuditur më shumë se për gjithçka. Aty ishte besoj vendi i vetëm në Shqipëri, ku fëmijët nuk i njohin llashtiqet, ato që edhe në fëmijë të qyteteve kemi bërë dëme të mëdha me shpendët. Pemët frutore që gjenden kudo i afrohen të gjithëve, vendas e të huaj që u bie rruga andej.

Por Mokra si gjithë vendet e tjera, ka shumë emigrime e migrime. Jo shpërtësiht, por nga nevoja dhe ndoshta përkohësisht siç shpreheshin shumë banorë të ikur që mu dha rasti

ti takoj, gjatë një viti që punova aty. Presim mbase dhe atje do të fillojë të bjerë era e investimeve, sepse tash as që bëhet fjalë.

Bishnica, ajo qendër e fuqishme e industrisë drurit, që ziente nga jeta e puntorëve, të pa fund të pyejeve dhe stabilimentit, tani kur rruga ka ardhur duke u bërë më e pa kalueshme, kur spitali nuk funksionon më, kur stabilimenti është mbyllur, është kthyer në një bukuri natyrore jo të rregullt nga vetë njerëzit. Janë larguar banorët rrugëve të kurbetit, jo për lluks, por për bukën e gojës sepse vetë realiteti, gjendja e shtëpive ambjenteve flet se sa kanë fituar ata njerëz.

Aty as celulari nuk afron sherbim, përveç në disa vende të rralla. Patatja, fasulja, rakija

e të tjera prodhime bio të mrekullueshme të zonës, tani janë të pakta se nuk ka kush të punjë e ti prodhojë, ca më tepër ku do të shiten ato prodhime.

Edhe Losniku gëzon të njëjtin fat. Shtëpi të braktisura, çatira që të ftohshpirtin kur kalon pranë tyre, ato që dikur të kapnin për krahu dhe të ulnin tek oxhaku, kur rakia e kumbullës e zier dy herë nuk mungonte kurrë, jetojnë pak, shumë banorë. Disa ikën në emigracion, disa kanë blerë tokë në fshtarat e Pogradecit e të Korçës sepse shkollën që kishin e kanë mbyllur, shërbimi shëndetsor nuk ekziston. Të vjen keq kur fëmijët e klasës parë ecin në këmbë, nëpër shi e dëborë deri në Slabinjë, sepse

nga rruga e keqe dhe pamundësia ekonomike, nuk ka asnjë mjet transporti ti çojë në shkollë.

Dikujt mund ti tingëllojë si keq dashje ky shkrim, por më mirë ta shohim realitetin në sy dhe të mos gënjejme vehten, ku përveç deputetit të zonës zotit Fatbardh Kadili i cili është i prokuptuar dhe po punon mendoj se pushteti vendor, Kryetarët e komunave nuk punojnë sa duhet, sepse si shpëgohet që për gati njëzet vjet nuk është bërë asnjë dyqan e jo më ndonjë objekt social-kulturor.

Por Mokra është e të gjithëve e do doja ta shihja ndryshe këtë vend. Jo me toka të rreshqitura që të plasnin shpirtin por me industrinë e drurit të gjallëruar, me industrinë minerare të aktivizuar, me hidrocentrale që për hir të së vërtetës po bëhen nga privatët.

Nga Zenun FERRO



Aranitët dhe Mokra



Aranitët njihen prej vitit 1001 deri në vitin 1600, plot 600 vjet, derë feudale e madhe në Shqipëri, i pari ka qënë David Araniti nga viti 1001-1018, sulmoi bullgarët në Skrapar në kohën e perandorit Vasili II. Davidi u bë Dukë i Shkupit

Djali Davidit, Konstandini ishte gjeneral në ushtrinë binzantine në Ballkan, dhe u vra në luftë në vitin 1050, për t'u mbrojtur nga sllavët e uraleve.

Në vitin 1274 Sevast Araniti ishte, një feudal i vogël dhe në vitin 1319, aranitët u bënë më të fortë.

Araniti në vitin 1319 i drejtohet Papës në Francë, se në Francë ishin transferuar papët nga Roma, që të luftohej kundër mbretit serb, që kishte pushtuar Shqipërinë, në një vijë prej Durrësit deri në Dibër.

Një dokument i vitit 1304, tregon se aranitët kishin lidhje me fiset e tjera të Shqipërisë së mesme, siç ishin albët, shpatarakët, Tërbaçët në Kërrabë, Skurajt në Durrës-Tiranë, një matjan etj.

Në vitin 1392, i pari i aranitëve bëhet Komin Shpata. Komnen ishte i pari prej fisit të madh, dhe Komin Shpata ishte babai i Gjergj Aranitit Komnen Topisë.

Aranitët në kohën e Komnenit, ku në Shpat në atë kohë futej edhe Vërça e Dumreja, aranitët vunë nën kontrollin e tyre Myzeqenë, Lushnjën, Mallakastrën, Tepelenën, ku akoma ka edhe një fshat që quhet Golem. Fshatra Golem ka edhe në Kavajë, Lushnje e tjera.

Fuqia aranite u bë e madhe, më e madhe se në kohën e Skënderbeut. Ato kishin dy qendra, një qendër në Librazhd, dhe një tjetër matanë lumit të Se-

manit. Aranitët më të shquar kanë qënë Gjergj Araniti dhe dy nipit e tij Moisi Golemi dhe Muzaka i Agjelinës.

Fitoret e para të Gjergj Aranitit kundër pushtuesve turq u dëgjuan në të gjithë Europën, ai lidhi aleanca me Skënderbeun, Venedikun dhe Alfonsin e Napolit. Gjergj Araniti flet i pari në Kuvendin e Lezhës me 2 mars 1444, "Skënderbeun ta kemi në ballë, Në betejën e Beratit në vitin 1455, që ishte edhe Gjergj Aranitit i'u vranë 9000 luftëtarë, dhe i qëndroi besnik Skënderbeut deri në vdekje.

Në vitin 1457, Skënderbeu martohet me Donikën, të bijën e Gjergj Aranitit. Në vitet 1467-1468, në Mokër, Librazhd u bënë luftra të tmerrshme. Të paktën 20 mijë robër mori Mehmeti i dytë me vete. Këtu rrëmbeu edhe vajzën e Gjergj Aranitit, Marën, që e mori edhe gruaja. Sulltan Bajaziti i dytë, që zuri vendin e Mehmetit të dytë, është djali i saj.

Gjergj Araniti me gruan e dytë italiane, pati tre djem, Thomain, Konstandinin e Aranitin. Nga këta Konstandini u bë më i njohuri, ai përfundoi tek Papa e i Romës, në Itali. Provoi të vijë të çlirojë edhe Shqipërinë në vitin 1494, së bashku me peshkopin e Durrësit Martin Firmani, por i tradhëtoi Venediku.

Konstandini pati një djalë të vetëm, edhe atë e quanin Araniti, ai u vra në Itali në vitin 1551, dhe kështu u zhdukën aranitët në Perëndim.

Araniti djali i tretë i Gjergj Aranitit, u bë turk, në vitin 1486, erdhi guvernator në Himarë, ku u vra nga himariotët.

Aranitët kanë qënë kurdoherë në ballë të luftrave që

bëri Skënderbeu. Aranitët më të mëdhenj në shekullin 15-të kanë qënë Gjergj Araniti dhe dy nipat e tij, Moisi Golemi, që ishte i biri i një vëllait, dhe Muzaka i Angjelinës, i biri i një vëllait tjetër.

Moisi Golemi luftoi me Skënderbeun, dhe në vitin 1464 tradhëtoi, por u kthye prapë në Shqipëri. U zu nga turqit me tetë të tjerë në vitin 1465. Edhe Muzakën e Angjelinës e zunë gjallë në fushën e Vajkalit, afër Bulqizës.

Gjergj Araniti vdiq në vitin 1457, dhe gruaja e dytë italiane, Pierinë Araniti, në vitin 1467, kur ishte në Shqipëri, do të organizonte luftën kundër turqëve. Turqit në Mokër, Librazhd, majtas e djathtas Shkumbinit kishin mundur të kalonin vetëm një herë, në kohën e Mehmetit I-rë, dhe pastaj nuk depërtonin më deri në vitin 1467, për rreth 51 vjet nuk lejuan dot turkun në Mokër, Librazhd, i mbajtën mokrarët, çermenikasit.

Legjenda thotë se Sopotin turqit e morën se e tradhëtuuan tre shqipëtarë, një Shpatarak, një gostivar dhe një Bos nga Bërzeshta. Kjo nuk është e vërtetë për Bosin, për Shpatarkun dhe gostivarin nuk kam dokumenta. (Dhimtër S.Shuteriqi gazeta "Çermenika", Nr 16 mars-prill 2005).

Ilia Bosi, që ishte kryetar i këtyre krahinave në vitin 1467 do të mobilizonte 12 mijë luftëtarë nga Bërzeshta, Çermenika, Mokra e etje. Nuk mobilizojë vetëm në Bërzeshtën e tij, gjithë kjo ushtri.

Në Venedik, pasi kishte vajtur atje Skënderbeu shkuan edhe Ilia Bosi, dhe kërkonte që të ndihmonte Venedikun me armë, bukë, veshmathje e tje, që të luftonte kundër turkut. Në vitin 1466 turku i kishte shkatërruar krahinën e Mokrës, Çermenikës, kishte djegur deri në Bulqizë, duke shkatërruar Cidhën dhe duke vranë rreth 9000 banorë.

Në vitin 1466 turqit kishin ndërtuar edhe kështjellën e madhe të Elbasanit, ku mund të mbante brenda saj rreth 100-150 mijë vetë. Me të tillë forcë erdhën turqit por u thyen në Krujë, U thyen prapë në vitin 1467, pas një viti, Ilia Bosi ka luftuar kundër turqëve.

Vendiku i dha Bosit disa kuaj me ushqime, shumë pak gjë i dha Venediku dhe shqiptarët, dhe kështu Mokra, Çermenika, Elbasani pësuan humbjet e trupave të tyre të mëdha dhe të fundit kundër turqëve. Në këtë mënyrë mbaroi rezistenca kundër turqëve, Kruja u dorëzua në vitin 1478 dhe Shkodra 1479. Përfunduan luftrat e mëdha të shekullit 15-të, të Skënderbeut, 11 vjet pas vdekjes së tij.

MARTESA E VAJZAVE TË FISIT ARANITI ME TË HUAJT.

Fisi Araniti ka pasur krushqi me shumë shtete të Europës. Ato nisin nga martesat

në Greqi, Itali, Turqi, Qipro, Mal të Zi, Bullgari e deri në Gjermani e Francë.

Martesa e parë dokumentohet është ajo mes Irena Araniti Koment, e martuar me Filipin, mbret i Gjermanisë në vitin 1198. Në Itali martesë e parë është bërë mes Anës, të bijës së Aleks Aranitit në vitin 1204. Ana është martuar me Teodor Laskarin perandor i Nikeas në Greqi. Një tjetër martesë është bërë në Itali, Helena Anxhela Aranitit është martuar me mbretin e Puljas Manfred, kjo është bërë më 2 qershor 1259.

Në Francë u martua Izabela Araniti, me një prej dyerve fisnike, Anzhuinët. Është martuar në maj 1277, me Filipino Anzhuin. Në Mal të Zi. Gojka Araniti u martua me Albëen, vajza e Srazimir Bashës, princi i Zetës. Në vitin 1485, kur sundimi turk ishte shtrirë në gjithë vendin, Mehmet Pashë Araniti u martua me vajzën e Sulltan Bajazitit, Myver Sulltan. Bajaziti ishte Sulltan në Perandorinë Osmane gjatë viteve 1481-1512. Sulltan Mehmeti II, martohet me Gjylbehane Gjergj Araniti, i cili mbretëroi gjatë viteve 1451-1481.

Në vitin 1326, Teodora Araniti u martua me mbretin e Bullgarisë Mikele Shishmai II, në vitin 1487, Helena Araniti u martua me Mbretin e Qipros Xhovani Luzinjo.

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:
www.poradeci.com/mokra

Murat Kajaçka

Istref HAXHILLARI

Ca më parë e ca më vonë, tërë fshati hyri në kooperativë. Në fillim njerëzit me zor e përtpyën këtë emër të huaj. U vriste veshin, shumë i gjatë, pastaj me dy "o" sikur nuk soste njëra. Vështirë e patën edhe me fjalë të tilla si asamble, brigadë, emulacion e të tjera, që hynë bashkë me kooperativën dhe zunë rrënjë si ato shkorretat e dendura pranë kumbullave dhe arrave të fshatit. Skuadra dhe brigada në luftë domosdo hynin në punë, po tani dukeshin pa lezet, dalë boje. Dillikua i pati kapërcyer të tetëdhjetat, kur dëgjoi njerëzit t'i thërriste Asambleja, madje si shpesh. E mërztur i tha së bijës.

-Ç'kërkon Hasan Beu? U bë kaq kohë, nuk ndihet derëzë.

E gjora plakë gjer vdiq nuk e mori vesh ç'ishte Asambleja.

Murat Kajaçka as që i hynte në punë kooperativa me ata emrat e huaj të çuditshëm. Atij nuk i pëlqente dhe pikë. Nuk hyri me të tjerët, mbeti jashtë saj individ. Fshati e shikonte me habi këtë punë. Disa thoshin se e kishite rregulluar poshtë me ata të mëdhenjtë. Pati qenë partizan gjer në fund të luftës, madje jo dosido sa për numër, po komandant skuadre. Kur kujtonte atë kohë Murati thoshte.

-Përzumë hasmin e huaj.

Vetëm kaq mund t'i nxirrje me zor. Më tej heshte, sado ta ngacmoje. Nuk vinte kurrë në takimet me nxënësit e shkollës, ku e thërrisnin si ish partizan. Shmangej ngadalë, butësisht me gënjeshtër bindëse. Njëherë mësuesja e djalit të tij i lut shumë dhe ai pranoi, po nuk vajti.

-Pata sëmurrë lopën, - i tha asaj të nesërmen.

Gojë e liga thoshin se qe bërë pishman për punën e kësaj kooperativës ardhur pas lufte, po ata kishin punën e tyre, s'i bëhej vonë nga fjalët e botës.

Kurse për kooperativën ruante mendim të palëkundur.

-Kooperativa është vullnetare, - arsyetonte, - të bëhet mirë hyn, s'të bëhet mirë nuk hyn. Mua nuk më bëhet mirë.

Kur i futeshin shumë me argumenta të forta, shkonte ca më tej në kundërshtinë e vet.

-Nuk kam grua, më del ndonjë fjalë. Njeriu për një nder rron.

Jetonte vetëm me djalit e madh. Gruan e ndau tre vjet më parë. Ajo i mori djalit tjetër më të vogël.

-Nuk qe grua për të qenë, - përgjigjej kur e pyesnin.

Po të pinte ndonjë gotë shkonte nëpër dhembë të mërztur si me dy mendje.

-Grua pisanjose, as hundët nuk fshinte, shtëpia qelbej. E përse duhet një grua që nuk di të mbajë pastër shtëpinë?

Në fshat tregonin se gruaja e tij ishte zonjë, po ai... Eh, ku mbahej burrë një gjernar si Murati. E kishin parë shpesh kur e rrihte. Herën e fundit e rrahu aq shumë sa ajo mbeti sakate. Krahu e djathtë nuk e lëvizte lirisht, me zor e ngrinte deri te mesi. Pas kësaj nuk bëhej fjalë për pastërti, s'ishte e zonja të lante e fshinte.

E përzuri. Gjyqi ia dha gruas të dy djemtë, po ajo mbajti vetëm të voglin.

Dikur nga fillimi i kooperativës një komision propogande e

thirri Murat Kajaçkën në zyrat e fshatit. Kryetari i komisionit lokal, shumë i ri për atë barrë hijerëndë, i kërkoi të bashkohej me të tjerët.

-Është direktivë, - u përpoq t'i mbushte mendjen.

-E di, - tha Murati dhe sikur u mblodh nga ajo fjalë e huaj. - Pa shiko ç'u pjell mendja? Hej drejt, direktivë!

-Atëhere?

-Me baza vullnetare, - u përgjigj, - kush do hyn, kush nuk do s'hyn.

-Ti s'je më i mirë se të tjerët, - u krekos kryetari i komisionit lokal.

-E di, - tha Murati, - ka më të mirë, po ka edhe më të këqinj.

-Po bëhesh pengesë.

-Secili ka mendjen e tij.

-S'e ke mirë, - ngriti zërin i deleguari.

-I zoti e di ku pikon çatia, - u përgjigj gjakftohtë.

-Unë të lidh, - u nxehe tjetri, ngaqë nuk dinte ç'ti thoshte.

-Lidhmë, - tha Murat Kajaçka qetësisht.

Kryetari i komisionit lokal urdhëroi policin t'i vinte pranë. Murati zgjati duart pa asnjë kundërshtim. Ashtu vajti në Lokalitet ku ndodhej kryetari i komisionit të rrethit. Ky qe burrë i moshuar trupmadh, kockanjar nga ata autoritarët e rëndë, që të shtypin me peshën e tyre. Vinte në atë detyrë nga lufta, pasi pati kryer me sukses detyra të tjera më pak të rëndësishme nga kjo e krijimit të kooperativave bujqësore.

-Murat, po ti?

-Më lidhi ky shoku yt.

-Përse kjo marrëzi!? - u habit kryetari i rrethit.

Në luftë e kishte patur komandant Murat Kajaçkën, e njëjtte si trim dhe të besës. Përreth u grumbulluan kureshtarët. Shikonin të habitur burrin me duar të lidhura, që nuk e prishte fare terezinë. Situata u përkeqësua.

-Kundërshton të hyjë në kooperativë, - tha me krenari kryetari buzëqumësht i komisionit lokal.

-Hajvan! - e shau kryetari i rrethit, - lirojeni!

Polici u afrua ta zgjidhte, Murati nuk pranoi.

-Dua të shko kështu në Komitet.

-S'është nevoja, - i tha kryetari i rrethit.

-Është, - tha Murat Kajaçka dhe ngriti zërin për herë të parë, - ikën ky, vjen një tjetër. Të mësohen, kooperativa është vullnetare, kush do hyn, kush s'do nuk hyn.

Kështu mbeti individ, nuk e ngau më njeri. Kryetarin e komisionit lokal e shkarkuan dhe një vit më vonë e burgosën për shkelje me qëllim të parimit vullnetar në krijimin e kooperativave bujqësore. Kur e thirrën si dëshmitar Murati e mbrojti.

-Mos i vini faj djalit, aq dinte aq bëri.

Murat Kajaçka qe burrë i sh-

kurtër, i drejtë qiri. Me sytë e mëdhenj pa ngjyrë vështronte përreth duke kthyer kokën siç bën kau futur në zgjedhë. Nuk mund të thuash se ata sy vështronin, më shumë se kaq depërtonin deri në shpirt si turjela. Flokët e zbërdhlyur tamam kash-të thekri, nuk u thinjën, as i ranë si shumë të tjerëve në fshat. Xhakëtën e vishte vetëm me mëngën e krahut të djathtë, të majtin e mbante zhveshur. Kapa e kadifesë vendosur mënjanë përmbi sy i jepte fytyrës rrumbullake pamje dinake e tallëse. Të jepte përshypjen e njeriut të qetë, të sigurt.

E veçanta e tij qenë buzët e trasha pak të përveshura. Buza e poshtëme, më e përveshur se e sipërmja, e tregonte buzëgaz përherë, ndaj nuk merrej vesh në qe i mërztur apo i gëzuar. Vështirë të harrohej kollaj fytyra e tij stoike, e padepërtueshme, që ia fshihite aq mrekullisht emocionet. Shumë gjëra kishte parë në këtë jetë të turbullt Murat Kajaçka. Një pjesë e njerëzve, sidomos të rinjtë dhe disa të tjerë e shikonin vëngër, por ai nuk mërztitej. U fliste të gjithëve me dashuri. Shumica e donin Muratin. E donin dhe u vinte keq se ishte individ pa grua, vuan shumë. Ndonjëherë i thoshin se po të hynte në kooperativë do ta kishte më lehtë.

-E ç'do të bëjë kooperativa, më marton dot në këtë moshë? - bënte shaka dhe buza e poshtëme i përvishej më shumë.

-Sidoqoftë me shokë, - i thoshin.

-Me shokë, po qesja veç, - ua kthente.

Vështirë të hahashe me Murat Kajaçkën. Për çdo gjë e kishite përgjigjen në majë të gjuhës. Në fjalët e tij nuk gjeje asgjë kundër kooperativës. Operativi i zonës dinte të krijonte situata të besueshme, ku patën rënë njerëz jo aq mendjelehtë, sidomos nga ata të prekurit. Murati e kishte këtë cen si individ. Operativi u mundua shumë t'i gjente ndonjë kleçkë, po i hasi sharra në gozhdë.

-Shumë rrëmujë kjo kooperativa, - i tha një ditë i mërztur, sikur kërkonte mendim të pjekur për ndryshimin e gjëndjes.

-Pse? - e pyeti Murati.

-Po ja s'e merr vesh i pari të dytin.

-Nuk e di, unë jam individ. Duhet të bisedosh me ata që janë në kooperativë.

-Ti e shikon si venë punët.

-Përsa e shikoj më duket shumë mirë, - i tha, - vetë hynë me dëshirën e tyre, u bëhej mirë, ndryshe pse do të hynin?

Operativi e shikoi me dyshim. Mos tallej ky plak që dukej budalla dhe qesharak me buzët e përveshura dhe kapën hedhur çapraz mbi kokë?

Murat Kajaçka donte të hynte në diskutime në prani të njerëzve përreth. Ata e dëgjonin me vëmendje, vinin buzën në gaz me

argumentat e tij. Asnjë nuk ishte i zoti sa Murati. Filozofia e tij e thjeshtë përmbledhej në pak fjalë: "Mos bjer kurrë në duart e të tjerëve, të jesh zot i vetvetes në çdo rrethanë". Të mbushte mendjen me të butë, nuk shante njeri, as mërztitej kurrë. Të deleguarit duronin sa duronin, pastaj shpërthenin dhe tërë propaganda e tyre thërrmohej. Të shumtët tërhiqeshin të mundur, bëheshin qesharakë në sy të njerëzve.

-Nuk e ke mirë, - i tha një ditë Hekurani të cilën e respektonte veçan të tjerëve se qe i drejtë, pa hile.

-Është vullnetare, - ia ktheu, - kush do hyn, mua nuk më bëhet mirë.

-Leri përçartjet, folë drejt, nuk je në mbledhje këtu, - u nxehe Hekurani.

Murat Kajaçka vuri buzën në gaz. Ato fjalë i qenë bërë mburojë, i shpaloste vend e pa vend.

-E di si është puna Hekuran, mua nuk më pëlqen kooperativa jo vetëm për ata emrat e huaj të ngatërruar. Dua të shkoj në punë kur bëhet mirë e jo kur të më urdhërojnë, purtekën s'e kam qef, as urdhërat. Në luftë qe ndryshe, pa ndërlikime, pa u marrë vesh nuk shporrej armiku i huaj. Po tani përse?

Sikur u bë pishman ngaqë përmendi luftën. U mendua një copë herë pastaj vazhdoi.

-E di që nuk më nxjerr fjalë.

Hekurani e shikoi me bezdi e inat përzier.

-E de, se thashë nuk të rashë, - ia ktheu Murati, - pa më thuaj si je me ekonominë tënde ti?

-Ashtu, - u përgjigj Hekurani, - ka më keq.

-Këtë dimër u kam dhënë be-reqet disave.

-Epo, punon vetë, merr vetë. -Aty ta kam.

-Mirë o mirë po nuk i bihet murit me kokë, - i tha Hekurani butë me njerëzillëk.

Murati qeshi përsëri aq sa buza e përveshur iu mbush me pështymë.

-E di atë historinë e dhenve ti?

-Jo, ku e ke fjalën?

Murat Kajaçka tregoi historinë, që nuk dihet në e shpiku vetë apo e pati dëgjuar.

Tre barinj mbanin nga një tufë dhen. Vuanin shumë, po puna u ecte. Gjë e gjallë shtohet, bulmeti po ashtu. Njërit i vajti mendja të bashkonin tufat, të punonin së toku, të ndanin prodhimin barabar mes tyre.

-Si puna e kësaj kooperativës, - nënqeshi me djallëzi Murati.

Hekurani u venjt i dogëndisur.

Të tjerët e gjetën me mend kërkesën dhe u bashkuan. Kaloi vetëm ndonjë vit e pak, hyri hilja në mes. Ai që kishte radhën i çonte afër, nuk e kërkonte kullotën. I shpije tjetri nesër, thoshte me vete. Njëloj shpresonin edhe shokët e tij. Zuri të bjerë prodhimi, të firohet bagëti, shkurt rrokullimë. E panë, nuk ishte gjë ajo punë dhe

mallkuan.

-Gjënë e bashkët e dhjeftë qeni.

Pastaj ndanë ato që u mbetën. U desh kohë e gjatë të arrinin derexhenë e mëparshme, të rregullonin atë që prishën me duart e tyre.

Hekurani tundi kokën i menduar.

-Gjëra me zarar, - tha dhe iku në punën e vet.

Në fillim njerëzit e shikonin Murat Kajaçkën si të prapambetur. E quanin konsevator, të mykur me mbeturina te vjetra patriarkale. Fjala individ lëshohej me përbuzje si të thoshin kurvar apo hajdut. Ai bënte sikur s'kuptonte. Më shumë e dogëndisnin ato fjalët e huaja të gjata si fshikulla shkoze me noga. Ta shanin vendçe do të qe më mirë.

Të gjithë shkonin tok në punë sapo binte çanga, bënin shaka, mbanin nëpër gojë njëritjetrin. Fillonin punë me urdhër, pushonin me urdhër, e ndërprisnin po ashtu. Murati përgatitej me nge, i vetëm me hajvanët e tij dhe djalit e vogël. Edhe ai bënte shaka me të birin, qetë, kalin sipas mënyrës së tij.

-Si thua, ne e kemi mirë apo ata? - pyeste djalit.

-Nuk e di, shokët më thonë individ, - ia kthente vogëlushi.

-Pse nuk u thua kanë lopë e bagëti ata?

-U kam thënë.

-E?

-I mbajmë stallave thonë, jo në shtëpi.

-Stallat i ka kooperativa.

Djali ngrinte supet.

-Duro, do ta shikosh ne jemi më mirë se ata, - e mbyllte Murati

Kooperativa filloi të mos i pëlqente edhe për mbledhjet e shpeshita, çangën që binte tri herë në ditë, urdhërat poshtë e lart. Më shumë nga të gjitha nuk e donte për fukarallëkun e njerëzve.

-Nga do të punosh nesër? - e pyeti një ditë Hekuranin.

-Ku të na thotë Feriku, - u përgjigj ai pa i rënë hiles.

-Feriku s'ka patur ara e gjë të gjallë ndonjëherë, ku e di radhën e punës?

-E po, brigadier hesapi, - u vrejti Hekurani dhe ndjeu sikur iu derdh në shpirt një trishtim i ëmbël i sinqertë.

Murat Kajaçka u zgërdhi, buza e poshtëme iu përvesh më shumë.

-Ju të kooperativës nuk duhet të mërztiteni, - i tha, - ndryshe puna ime, jam individ.

-Mjaft, - i tha Hekurani, - kooperativa është poshtërsi, janë bërë njerëzit të flasin me vete. Kujt i shko mendja për këtë budallëk?

I pati vajtur në majë të hundës. Të gjitha i duroi, fukarallëkun jo. Në djalit të vinte, më keq se aq...

Nuk fliste kurrë me njeri, vetëm në shtëpi thërriste, nxirrte dufin me të shoqen. Tani nuk duroi, iu hap Muratit.

-Paske qenë i mençur, - i tha.

-Ç'thua, përse?

-Nuk hyre në kooperativë.

-Me zor nuk të futën, - ia ktheu Murati, - deshe vetë pa hyre. Mua nuk m'u bë mirë.

-Tani s'dal dot se, - i tha Hekurani dhe qeshi për herë të parë me ato fjalët e përçartura të individit Murat Kajaçka.